



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**  
**Sekretaria**

Nr. Prot.

Tiranë, më .09.2024

**MBLEDHJA Nr. 33,**  
**Datë 12.09.2024, ora 11:30**  
**e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 12.09.2024, ora 11:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 33 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 03.09.2024.
2. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa ndryshimeve në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar.
3. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2024 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35KV.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “MAGNA SOLAR POWER” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "NOA ENERGY TRADE" sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “PARISOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “REBESOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “SAMASOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
9. Mbi kërkesën e shoqërisë “ZENINA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

10. Mbi kërkesën e shoqërisë “DRIBEN” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
11. Mbi operimin deri në 10% mbi kapacitetin e identifikuar në Aneksin A, të licencës për prodhimin e energjisë elektrike.
12. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për lëshimin e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga parku fotovoltaiik “Blue 1”, për muajin korrik 2024.
13. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al), jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**